

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"AMG Food" e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg kokainë
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/14/amg-food-e-skandalit-te-salmoneles-pronare-e-kontejner-it-me-mish-pule-ku-u-gjeten-41-kg-kokaine/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 18:04:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:54:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	91f52a3261853a52235f06899a18ac4c9322a265c2b0fa128b81afd46670f898
TEKSTI	27990462caba7fef3a8beb476b4b030f855f9101c65913514505b1d6a60e9be3
PAMJA	dad9dd551ecfdbfc47178e9752da3a7d772be97ac6dab47e79c7c241772e6ff5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9ac9f106b9a17de87b3d21599659aef71b1e6b204fa06b19f0621febcc4f5074
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9ac9f106b9a17de87b3d21599659aef71b1e6b204fa06b19f0621febcc4f5074>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“AMG Food” e skandalit të Salmonelës, pronare e kontejnerit me mish pule ku u gjetën 41 kg kokainë

Kryesore

Publikuar: 14/09/2026



Detaje të reja kanë dalë në dritë nga **operacioni** i zhvilluar ditën e sotme në Portin e Durrësit, ku Policia sekuestroi **41 kg e 350 gramë kokainë**, me një vlerë tregu që përlogaritet rreth **2 milionë euro**.

Droga u zbulua në një **kontejner me origjinë nga Brazili**, i cili sipas dokumentacionit transportonte **mish pule**. Gjatë kontrollit, efektivet gjetën 37 paketime me lëndë të dyshuar narkotike kokainë të fshehura në kapakët e jashtëm të kontejnerit.

Sipas **MCN**, kompania që kishte porositur ngarkesën e mishit të pulës, ku u gjetën edhe 41 kilogramët e kokainës, është **AMG Food**, me administrator/pronar **Arben Goxhaj**.

Kompania rezultoi të jetë e lidhur me ngarkesën e kontrolluar nga autoritetet në Portin e Durrësit, ndërsa mbetet për t'u përcaktuar nga hetimi nëse porositësit e ngarkesës kanë pasur dijeni për lëndën narkotike të fshehur në kontejner.

Emri i **AMG Food** nuk është i panjohur për autoritetet shqiptare. Kompania ishte përfshirë edhe në një tjetër çështje të bujshme në mars të vitit 2025, kur një ngarkesë me mish pule të importuar nga Brazili **rezultoi e kontaminuar** me bakterin **Salmonella Typhimurium**.

Në atë rast, autoritetet ushqimore bllokuan një sasi të mishit, ndërsa sipas raportimeve, një pjesë e produktit kishte dalë në treg. Hetimi u zgjerua edhe ndaj personave përgjegjës për importimin dhe shpërndarjen e ngarkesës.

Me të lexuarat

- Bosi i Lurrës**
hap kartel kompanish dhe fondacionesh. A po pastrojnë në ndërtim?

- Rakunë zohen**
Pashtrimit...

- Alarm të rremë**
për bomba në shkollë, arrestohet

- Mandi i atagan!**
Krejt i dorës!
Ili Topi...
mashtron me formularin e dekriminalizimit dhe pasurinë, afëra me depot

- Lufta e padukshme**
e Kremlinit: nga kokat e derrave të ndërhyrjet në zgjedhje
Pagat e gjyqtarëve/
Avokati: Debati duhet të jetë për ndarjen e pushteteve, jo për shifrat


Në prill 2025, **Arben Goxha**, i lidhur me AMG Food, u ndalua pasi ishte shpallur në kërkim në lidhje me çështjen e mishit të pulës me salmonelë. Ai dhe persona të tjerë u hetuan në kuadër të këtij rasti.

Tashmë, më shumë se një vit pas këtij episodi, kompania del sërish në vëmendje të autoriteteve. Megjithatë, deri në këtë fazë nuk ka një të dhënë zyrtare që lidh kompaninë me trafikimin e kokainës.

Hetimet e Policisë dhe Prokurorisë pritet të përcaktojnë nëse porositësit e ngarkesës kishin dijeni për drogën e fshehur në kontejner.

TAG: [Amg food](#) [kontenieri me drogë](#) [Mish pule](#) [pronare](#) [skandali i salminelës](#)

Të ngjashme



Drama e shpopullimit / Shkolla që ka vetëm 1 nxënës në Neviçishtë të Korçës, mbyllet



Bosi i Lufrës hap kartel kompanish dhe fondacionesh. A po pastron në ndërtim paratë e mashtrimit me shitjen e qumështit me kimikate? Ortakëria e Ar...



Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

- KREU INVESTIGIM
- KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
- KRYESORE POLITIKË EKONOMI
- ANALIZË RAJON KULTURË SPORT



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)